



**SIGMA**

**Mbështetje për përmirësimin e Qeverisjes dhe të Menaxhimit**  
**Një iniciativë e përbashkët e OECD dhe Bashkimit Europian, financuar kryesisht nga BE**

## **LISTË KONTROLLI MBI HARTIMIN E LIGJIT DHE MENAXHIMIN RREGULLATOR NE EUROPËN QENDRORE DHE LINDORE**

**DOKUMENTI I SIGMA NR. 15, 1997**

Ky dokument është përgatitur me mbështetjen financiare të Bashkimit Europian. Pikëpamjet e paraqitura në të nuk përfaqësojnë opinionin zyrtar të Bashkimit Europian dhe nuk pasqyrojnë domosdoshmërisht pikëpamjet e OECD-së dhe të vendeve anëtare të saj apo të vendeve përfituese, pjesëmarrëse në Programin SIGMA.

## PROGRAMI SIGMA

Programi SIGMA - Mbështetje për Përmirësimin e Qeverisjes dhe të Menaxhimit në vendet e Europës Qendrore dhe Lindore - është një nismë e përbashkët e Qendrës për Bashkëpunim me Ekonomitë në Tranzicion të Organizatës për Bashkëpunim Ekonomik dhe Zhvillim (OECD) dhe Programit Phare të Bashkimit Europian. Iniciativa mbështet përpjekjet për reformën e administratës publike në 13 vende në tranzicion dhe financohet kryesisht nga Phare.

Organizata për Bashkëpunim Ekonomik dhe Zhvillim është një organizatë ndërqeveritare e 29 demokracive me ekonomi tregu të përparuara. Qendra i kanalizon këshillat dhe ndihmën e Organizatës në një numër të madh çështjesh ekonomike për reformimin e vendeve të Europës Qendrore dhe Lindore dhe në ish Bashkimin Sovjetik. Programi Phare jep grante financimi për të mbështetur vendet e tij partnere në Europën Qendrore dhe Lindore deri në fazën kur ato të jenë të gatshme të marrin përsipër detyrimet që rrjedhin nga anëtarësimi në Bashkimin Europian.

Phare dhe SIGMA u ofrojnë shërbime të njëjtave vende: Shqipëri, Bosnje-Hercegovinë, Bullgari, Republika Çeke, Estoni, Ish-Republika Jugosllave e Maqedonisë, Hungari, Letoni, Lituani, Poloni, Rumani, Sllovaki dhe Slloveni.

E krijuar në vitin 1992, SIGMA funksionon brenda Shërbimit të Menaxhimit Publik të OECD-së, që u ofron politikëbërësve informacione dhe ekspertizë në lidhje me menaxhimin publik dhe lehtëson kontaktet dhe shkëmbimin e përvojave midis menaxherëve të sektorit publik. SIGMA u ofron vendeve përfituese akses në një rrjet administratorësh publikë me përvojë, informacione krahasuese dhe njohuri teknike që lidhen me Shërbimin e Menaxhimit Publik.

SIGMA synon:

- Të ndihmojë vendet përfituese në përpjekjet e tyre për qeverisje të mirë për të përmirësuar efikasitetin administrativ dhe për të nxitur personelin e sektorit publik t'u përmbahet vlerave demokratike, etikës dhe respektimit të shtetit ligjor;
- Të ndihmojë për krijimin e kapaciteteve vendase në nivelin e qeverisjes qendrore për t'u bërë ballë sfidave të globalizimit dhe planeve të integritimit në Bashkimin Europian; dhe
- Të mbështesë nismat e Bashkimit Europian dhe të vendeve të tjera donatore për t'iu ardhur në ndihmë vendeve përfituese për reformimin e administratës publike dhe për të kontribuar në koordinimin e aktiviteteve të donatorëve.

Në të gjithë punën e saj, kjo iniciativë i jep përparësi të lartë lehtësimit të bashkëpunimit midis qeverive. Kjo praktikë përfshin ofrimin e mbështetjes logjistike për krijimin e rrjeteve të nëpunësve të administratës publike në Europën Qendrore dhe Lindore, si edhe midis këtyre nëpunësve dhe homologëve të tyre në demokraci të tjera.

SIGMA punon në pesë fusha teknike: Reforma Administrative dhe Strategjitë Kombëtare, Menaxhimi i Politikëbërjes, Menaxhimi i Shpenzimeve, Menaxhimi i Shërbimit Publik, dhe Mbikëqyrja Administrative. Përveç këtyre, një Njësi e Shërbimeve të Informacionit shpërndan materiale të botuara dhe në internet mbi tema të menaxhimit publik.

Për më shumë informacion mbi Programin SIGMA, shihni faqen tonë të internetit:

<http://www.sigmaweb.org>

**Të drejtat e autorit: OECD**

**Ky material është botuar për herë të parë në gjuhën angleze nën titullin: *Checklist on Law Drafting and Regulatory Management in Central and Eastern Europe.***

**OECD autorizon përdorimin e këtij materiali pa pagesë, për qëllime jo-komerciale. Të gjitha kërkesat për përdorim për qëllime komerciale ose për marrjen e të drejtave të përkthimit të materialit duhet të dërgohen në adresën elektronike [rights@oecd.org](mailto:rights@oecd.org).**

## PARATHËNIE

Vendet e Europës Qendrore dhe Lindore duhet të rishikojnë dhe të përshtatin kuadrin e tyre ligjor me standardet e Bashkimit Europian, si pjesë e procesit të pranimit në BE. Kjo bën që hartimi i një legjislacioni me cilësi të mirë dhe “të zbatueshëm” të jetë një shqetësim madhor.

Duke botuar këtë listë kontrolli, SIGMA synon të ofrojë një mjet metodologjik për vlerësimin e ndërtimit institucional, të procedurave dhe të teknikave për hartimin e legjislacionit të miratuara në vendet e Europës Qendrore dhe Lindore, dhe të identifikojë mjetet që mund të ndihmojnë kur mendohet të bëhen ndryshime. Kjo listë mbështetet në përvojat praktike dhe në praktikat e përdorura në vendet anëtare të OECD si edhe në vendet e Europës qendrore dhe lindore. Çeklista nuk ka për qëllim të jetë një dokument i detyrueshëm dhe as të një direktive mbi mënyrën e trajtimit të aktiviteteve të veçanta. Për më tepër, ajo synon të identifikojë në një mënyrë të hollësishme një larmi çështjesh të cilat duhet të merren parasysh për të garantuar një cilësi të mirë të ligjit. Natyrisht që zgjedhjet aktuale në këto drejtime duhet të pasqyrojnë rrethanat lokale.

Ky botim është bazuar në një pyetësor i cili u përgatit për një projekt të filluar në vitin 1997 nga SIGMA mbi “Hartimin e ligjit dhe Menaxhimin Rregullator në vendet e Europës Qendrore dhe Lindore”. Ky projekt ka çuar në botimin e një dokumenti të veçantë të SIGMA-s me titull “Hartimi i ligjit dhe Menaxhimi Rregullator në vendet e Europës Qendrore dhe Lindore”, i cili do të mund të jetë i disponueshëm përmes SIGMA-s. Çeklista, e shkruar me kërkesën e SIGMA-s nga Prof. Keith Patchett i Universitetit Britanik të Kardifit, përmban pyetje mbi zhvillimin e politikave, strukturën organizative, stafin, hartimin aktual dhe vlerësimin e impaktit. Për ta bërë një mjet me metodologjik praktik, struktura e çeklistës përpiket të pasqyrojë sa më shumë që të jetë e mundur zhvillimin e instrumenteve ligjore në rend kronologjik.

Çeklista synon të ndihmojë stafin përgjegjës për vlerësimin dhe organizimin e procesit të hartimit të legjislacionit dhe stafin përgjegjës për hartimin e legjislacionit për të rritur ndërgjegjësimin e tyre për aspekte të ndryshme të hartimit të një ligji të mirë. Megjithëse audienca e synuar përbëhet nga nëpunësit publikë në Europën Qendrore dhe Lindore, ajo nuk kufizohet në këtë rajon meqë hartimi i ligjit dhe menaxhimi rregullator janë nën vëzhgim në shumicën e demokracive në botë. Për më tepër, lista e kontrollit mund të jetë një mjet i dobishëm për komunitetin e donatorëve.

Për më shumë detaje, përfshirë edhe aktivitetet e SIGMA-s në këtë fushë, ju lutemi kontaktoni Anke Freibert ose Michal Ben- Gera në adresën më poshtë.

Një fjalor termash të përdorura në listë është dhënë në Shtojcën 1.

## PËRMBLEDHJE EKZEKUTIVE

Zhvillimi i një kuadri rregullator të tillë që t'u përmbahet standardeve të BE përbën një shqetësim madhor në vendet e Europës Qendrore dhe Lindore. Kjo bëhet me qëllim që jo vetëm të nxitet zhvillimi ekonomik, por edhe të garantohet mirëqenia e qytetarëve. Për arritjen e këtij qëllimi, ka rëndësi të krijohet një strukturë e mirë institucionale e cila të organizojë stafin e kualifikuar në hartimin e ligjit, të ndërtojë procedura efçente për koordinimin dhe konsultimin dhe të garantojë që të vlerësohet ndikimi i mundshëm i instrumenteve të reja ligjore para se ato të miratohen.

SIGMA-s i është kërkuar nga disa prej vendeve përfituese t'i ndihmojë ato në këtë detyrë jashtëzakonisht të vështirë për të ndërtuar struktura dhe procedura efçente dhe efektive për hartimin e ligjit. Përveç disa seminareve që janë organizuar në lidhje me çështje të rëndësishme për hartimin e ligjit, kjo çeklistë është ndërtuar për t'u dhënë vendeve edhe një mjet shtesë për vetë vlerësime.

Kjo çeklistë ofron një mjet për vlerësimin e strukturave, të procedura dhe të teknikave për përgatitjen dhe hartimin e legjislacionit dhe për identifikimin e metodologjive që mund të jenë të dobishme kur mendohet të bëhen ndryshime. Hartimi i ligjit kalon në dy faza: hartimi i politikave dhe përgatitja e tekstit legjislativ për t'i dhënë fuqi politikës së miratuar. Lista merret kryesisht me këtë të dytën.

Çeklista mbështetet në përvojën e grumbulluar në vendet e OECD dhe të Europës Qendrore dhe Lindore. Në mënyrë të veçantë, ajo merr parasysh punën e kryer nga Grupi i Menaxhimit Rregullator dhe i Reformës të Shërbimit të Menaxhimit Publik të OECD-së (PUMA) dhe shqetësimet e Programit Phare të BE të shprehura në kontekstin e përafrimit të legjislacionit në kuadrin e pranimit në BE.

Lista e kontrollit është ndërtuar të ofrojë një mjet praktik për të gjithë ata që merren me krijimin ose vlerësimin e procesit të hartimit të legjislacionit. Ajo në këtë mënyrë mbulon jo vetëm çështjet që kanë të bëjnë me rregullimin në vetvete, por edhe me çështje organizimi dhe plotësimi me personel.

Organizimi i procesit të hartimit, përfshirë këtu plotësimin me staf të përshtatshëm, përbën bazën themelore për prodhimin e instrumenteve të mira ligjore. Përveç kësaj, është vërtetuar se është e rëndësishme të ndërmerret një larmi verifikimesh edhe gjatë procesit të hartimit të politikave edhe të procesit të hartimit të ligjeve.

Lista mbulon në kapituj të veçantë çështjet e mëposhtme:

- Kontrollat e politikave
- Organizimin e hartimit të ligjit
- Hartimin e legjislacionit parësor
- Hartimin e legjislacionit dytësor
- Verifikimet e posaçme të drafteve legjislative
- Publikimin e legjislacionit.

Çështjet e paraqitura në kapitullin Organizimi i Hartimit të Ligjit lidhen me kuadrin rregullator, personelin hartues, instrumentet për verifikimin e drafteve, përdorimin e teknologjisë kompjuterike dhe procedurat e konsultimit. Dy kapitujt e tjerë merren me hartimin e legjislacionit parësor e dytësor dhe sugjerojnë çështje në lidhje me procedurat, caktimin e detyrave, shtrirjen në kohë, dhe rolin e parlamentit në përgatitjen e dy tipeve të legjislacionit.

Për t'u garantuar që hartimi i ligjit të prodhojë instrumente ligjore të qarta, konsistente dhe të zbatueshme, në kapitullin përkatës janë trajtuar një numër i posaçëm verifikimesh si përputhja e legjislacionit dhe e amendamenteve të tij me kushtetutën, me ligjin ekzistues dhe sistemin ligjor ekzistues, si edhe me detyrimet ndërkombëtare.

Verifikimet kanë të bëjnë edhe me përafrimin me legjislacionin e BE-së, me zbatimin dhe formën ligjore, qartësinë, plotësinë dhe zbatueshmërinë.

Përpunimi i një propozimit të një politike gjatë procesit hartues mund të prodhojë një skemë legislative që mbulon një gamë të gjerë çështjesh ose të hapë rrugën për masa më komplekse sesa ato që ishin parashikuar fillimisht. Në raste të tilla, me t'u përgatitur drafti, mund të paralajmërohen verifikime të mëtejshme të politikave të nivelit të dytë.

Kontrollet në lidhje me burimet dhe publikimin e legjislacionit kanë të bëjnë me subjektet, si për shembull, ku mund të gjendet teksti i legjislacionit (për shembull, në gazetën zyrtare, në bazën e të dhënave), me kërkesat për publikimin, me autoritetet përgjegjëse, me aksesin prej palëve të interesuara dhe me buxhetimin.

## PASQYRA E LËNDËS

<b>PROGRAMI SIGMA</b> .....	<b>2</b>
<b>PARATHËNIE</b> .....	<b>3</b>
<b>PËRMBLEDHJE EKZEKUTIVE</b> .....	<b>4</b>
<b>PASQYRA E LËNDËS</b> .....	<b>6</b>
<b>HYRJE</b> .....	<b>8</b>
<b>KONTEKSTI I POLITIKAVE</b> .....	<b>9</b>
<b>A. KONTROLLET PËR POLITIKËN</b> .....	<b>10</b>
A1. Procedurat dhe instrumentet e verifikimit.....	10
A2. Qasja rregullatore.....	10
A3. Kërkesat administrative.....	11
A4. Kontrolltet e efektit .....	11
Kostot dhe efekti ekonomik .....	11
Efiçenca.....	12
Prakticiteti .....	12
Zbatimi.....	13
<b>B. ORGANIZIMI I HARTIMIT TË LIGJIT</b> .....	<b>13</b>
B1. Kuadri rregullator .....	13
B2. Personeli hartues.....	14
B3. Instrumentet për verifikimin e drafteve.....	15
B4. Përdorimi i teknologjisë kompjuterike .....	15
B5. Procedurat e konsultimit.....	15
<b>C. HARTIMI I LEGJISLACIONIT PARËSOR</b> .....	<b>16</b>
C1. Programi legjislativ dhe kalendari kohor .....	16
C2. Procesi i hartimit.....	17
C3. Shqyrtimi parlamentar i legjislacionit parësor .....	18
C4. Formalitetet.....	19
<b>D. HARTIMI I LEGJISLACIONIT DYTËSOR</b> .....	<b>19</b>
D1. Dhënia e autoritetit për të hartuar legjislacionin dytësor.....	19
D2. Hartimi i legjislacionit dytësor .....	19
D3. Procedurat pas hartimit të legjislacionit dytësor .....	20
D4. Veprimi parlamentar .....	21
<b>E. VERIFIKIMET E POSAÇME TË DRAFTEVE LEGJISLATIVE</b> .....	<b>21</b>
E1. Përputhja me kushtetutën .....	21
E2. Përputhja me ligjet dhe sistemin ligjor ekzistues.....	22
E3. Përafrimi me legjislacionin e BE-së.....	22

E4.	Përputhja me detyrimet e tjera ndërkombëtare.....	22
E5.	Kontrollet për zbatimin.....	23
E6.	Kontrollet për formën ligjore, qartësinë dhe kuptueshmërinë.....	23
E7.	Kontrollet e politikave pas hartimit.....	24
<b>F.</b>	<b>PUBLIKIMI I LEGJISLACIONIT .....</b>	<b>25</b>
F1.	Burimet legislative .....	25
F2.	Botimi i legjislacionit.....	26
	<b>SHTOJCA 1-Fjalor .....</b>	<b>27</b>
	<b>SHTOJCA 2- Lista e kontrollit e OECD-së për Vendimmarrjen Rregullatore .....</b>	<b>28</b>

## HYRJE

Në parim, hartimi i ligjit kalon në dy faza: hartimi i politikës dhe përgatitja e tekstit legjislativ për t'i dhënë fuqi politikës së miratuar. Në fazën e parë, duhet të merren vendime kyç për çështje të tilla si:

- cilat prej alternativave të ndryshme të politikave duhet të preferohen;
- a duhet të realizohet alternativa e preferuar më mirë përmes legjislacionit se sa me mjete jolegjislative;
- cilat autoritete duhet ta venë në fuqi legjislacionin; dhe
- cila është qasja bazë që duhet të miratohet në legjislacion dhe çfarë mekanizmesh ligjorë dhe administrative janë të nevojshme për ta vërë atë qasje në fuqi dhe për ta bërë atë funksionale.

Vendimet për çështje të tilla si këto duhet të merren para se të fillojë puna efektive për tekstin legjislativ. Marrja e këtyre vendimeve është tamam detyra e politikëbërësve që janë ekspertë në fusha të veçanta, përfshirë këtu edhe ata me ekspertizë të veçantë në fushën ligjore.

Në fazën e dytë, këto vendime kyçe të politikave duhet të konvertohen në tekst ligjor, pavarësisht se do të vazhdojnë të kërkohen politika të hollësishme dhe mendime juridike të ekspertëve mbi çështje themelore. Për t'i kthyer kërkesat e politikave dhe ato administrative në rregulla ligjore praktike, efektive dhe të qarta janë të nevojshme shkathhtësi të ndryshme dhe aftësi juridike. Hartuesit me përvojë për hartimin e ligjeve janë të zotë dhe dinë si t'i përdorin konceptet dhe terminologjinë juridike në kontekste legjislative dhe se si ta japin strukturën legjislative, formën dhe stilin.

Në disa sisteme, këto dy faza mund të mbahen formalisht të ndara, por në shumicën e vendeve të Europës Qendrore e Lindore këto dy faza ka mundësi të trajtohen nga zyrtarët e së njëjtës ministri ose i njëjti grup pune.

Megjithëse kjo listë merret kryesisht me fazën e dytë të procesit, pjesa e parë përshkruan llojet e kontrolleve që janë të vlefshme për hartimin e politikave. Në shumë vende hartuesve të ligjit u kërkohet të përgatisin dokumentacion shpjegues në mbështetje të legjislacionit që ata kanë hartuar (të ashtuquajturat “justifikime”), në të cilin duhet të përfshihet informacion mbi kontekstin, historikun e politikave.



## KONTEKSTI I POLITIKAVE

Vendet anëtare të OECD-së kanë zbuluar se cilësia e legjislacionit të tyre mund të rritet shumë nëse disa çështje trajtohen në mënyrë të veçantë. Në 9 mars 1995, Këshilli i OECD-së rekomandoi se kur ndërmerren veprime rregullatore duhet të bëhen gjithmonë pyetjet e mëposhtme:

1. A është përkufizuar problemi ashtu si duhet?
2. A është i argumentuar veprimi i qeverisë?
3. A është rregullimi forma më e mirë e veprimit qeveritar?
4. A ekziston një bazë ligjore për rregullimin?
5. Cili është niveli (nivelet) i përshtatshëm i qeverisë për këtë veprim?
6. A i justifikojnë përfitimet nga rregullimi kostot e tyre?
7. A është transparente shpërndarja e efekteve në të gjithë shoqërinë?
8. A është rregullimi i qartë, konsistent, i plotë dhe i aksesueshëm për përdoruesit?
9. A e kanë pasur mundësinë të gjitha palët e interesuara të paraqesin pikëpamjet e tyre?
10. Si do të arrihet përputhshmëria?

### *Rekomandimi i plotë gjendet në Shtojcën 2*

Është e qartë se shumica e këtyre janë pyetje shumë të rëndësishme për politikën që duhet të sqarohen përpara se të përgatitet çdo lloj legjislacioni (për shembull, pikat 1-6, 10). Mund të jetë nevoja që këto pyetje të bëhen për secilën prej alternativave të mundshme të politikave me qëllim që të përcaktohet se cila alternativë duhet të preferohet. Nga ana tjetër, pyetja 8 mund të merret në konsideratë vetëm nëse legjislacioni është hartuar. Në disa raste, pyetja mund të bëhet në secilën fazë (për shembull, 7 & 9). Për të shkuar më tej, një pyetje, megjithëse e marrë në konsideratë në fazën e politikëbërjes, mundet që disa herë të duhet të bëhet përsëri në fazën e hartimit të legjislacionit meqenëse del një skemë e detajuar në tekst.

Përgjigjet për të gjitha këto pyetje, pavarësisht se si dhe kur janë marrë ato, janë të rëndësishme për punën e hartuesit të ligjit. Në fakt, nëse hartuesve nuk u jepen përgjigjet përgjatë hartimit të politikës, ata mund të duhet t'i kërkojnë ato ose të përpiqen t'i sigurojnë ato vetë gjatë procesit të hartimit.

## **A. KONTROLLET PËR POLITIKËN**

*Vendet anëtare të OECD-së bëjnë verifikimet e mëposhtme si pjesë e një vlerësimi ex ante të projekteve legjislative për të përmirësuar besueshmërinë, efektivitetin dhe efikasitetin e kostos së ligjit. Kur është e përshtatshme, ato duhet të bëhen nga çdo organ përgjegjës për iniciimin e legjislacionit, si të atij parësor ashtu edhe, megjithëse në një shkallë më të vogël, të atij dytësor. Verifikimet duhet të mbështeten në proceset standarde të hartimit të legjislacionit që përdoren nga qeveria dhe, në lidhje me legjislacionin dhe amendamentet e tij të nisura nga parlamenti, edhe nga ai.*

*Këto pyetje nuk përqendrohen tek mjetet me të cilat mund të kryhen më mirë verifikimet e veçanta (për shembull, nga një organ qendror ekspertësh që vepron për të gjitha ministritë ose nga njësi me specialistë brenda ministrive të veçanta), dhe as tek çështja nëse këto verifikime duhet të kryhen me një veprim të vetëm. Kjo gjë varet patjetër nga prania dhe organizimi lokal i burimeve të specialistëve.*

### **A1. Procedurat dhe instrumentet e verifikimit**

- A1.1 A i identifikojnë aktet nënligjore se cilët janë personat ose organet përgjegjëse për kryerjen e verifikimeve të mëposhtme, në veçanti kur ato duhen kryer në nivel të qeverisjes qendrore ose nga ministritë e veçanta dhe kur puna mund të kontraktohet, për shembull, me agjencitë apo konsulentët e jashtëm?
- A1.2 A i është kushtuar vëmendje krijimit të një njësie të vetme qeveritare e cila të mund ta zhvillojë kompetencën e veçantë që kërkohet?
- A1.3 A japin aktet nënligjore udhëzime në lidhje me fazën e procesit hartues në të cilën duhet të kryhen këto verifikime (për shembull, kur alternativat e politikave janë marrë në konsideratë, ose kur një alternativë e veçantë është përzgjedhur, apo kur drafti i ligjit është plotësuar, apo në më shumë sesa vetëm në njërin prej këtyre fazave)?
- A1.4 A i parashikojnë ato procedurat që duhet të ndiqen, veçanërisht në ato raste kur janë zbuluar probleme në lidhje me projekt propozimet?
- A1.5 A parashikojnë aktet nënligjore se justifikimet e paraqitura me draftet e legjislacionit në këshillin e ministrave dhe në parlament duhet të përfshijnë një njoftim zyrtar se këto verifikime janë kryer dhe, veçanërisht informacion për kostot e parashikuara, për efektin financiar dhe implikimet buxhetore?
- A1.6 A janë marrë masa zyrtare për të garantuar se kontrole të ngjashme janë kryer në lidhje me draftet ose amendamentet ligjore të iniciuara nga parlamenti?
- A1.7 A duhet që instrumentet zyrtare në përdorim ose në ndërtim e sipër të ndihmojnë në vlerësimin *ex ante* të propozimeve politike për legjislacionin (për shembull, modelet e kompjuterave, simulimet, çeklistat)?
- A1.8 A është ngarkuar ndonjë organ (ose disa të tillë) qeveritar me përgjegjësinë e studimit të përvojës së vendeve të tjera për përdorimin e vlerësimit *ex ante*, për ndërtimin e instrumenteve të përshtatshme për përdorim lokal dhe për garantimin se ekzistenca e tyre është bërë e njohur për ata që mund ta përdorin atë?
- A1.9 A ka ofruar qeveria shanse për trajnim, në vend dhe jashtë tij, për përdorimin e vlerësimit zyrtar *ex ante*?

### **A2. Qasja rregullatore**

- A2.1 A ekzistojnë realisht procedura që garantojnë se problemi për zgjidhje mund të identifikohet me saktësi dhe në mënyrë korrekte, se natyra dhe shkalla e tij janë analizuar plotësisht, dhe se qëllimi

i tij është kuptuar tërësisht nga politikëbërësit dhe se objektivat e politikave mund të formulohen në mënyrë të vendosur?

- A2.2 A është një praktikë standarde e ministrive të ndërmarrin një analizë fillestare dhe verifikime të alternativave të politikave me qëllim që të përcaktojnë se si mund të arrihen objektivat?
- A2.3 A është procedurë standarde kryerja e një kontrolli të posaçëm nëse kërkohet apo jo legjislacionin e ri, për shembull, për shkak se çështja:
- është ose mund të trajtohet me ligjin ekzistues, ose
  - mund të trajtohet me ose pa veprim legjislativ (për shembull, nëpërmjet udhëzimeve administrative, të tilla si kontratat ose negociatat dhe marrëveshjet me palët e prekura)?
- A2.4 A janë verifikuar posaçërisht, gjatë fazave të politikëbërjes, propozimet dhe alternativat e politikave për legjislacionin e ri për përputhshmërinë e tyre me kërkesat e kushtetutës?
- A2.5 A janë verifikuar posaçërisht, gjatë fazave të politikëbërjes, propozimet dhe alternativat e politikave për legjislacionin e ri, për përputhshmërinë e tyre me ligjet dhe strukturat ligjore ekzistuese?

### **A3. Kërkesat administrative**

- A3.1 A është praktikë standarde të formohet për çdo projekt të ri legjislativ niveli më i përshtatshëm në qeveri në të cilin duhet të zbatohet skema e re?
- A3.2 A është praktikë standarde të kryhet një kontroll për secilin projekt të ri legjislativ, për të garantuar:
- se strukturat organizative dhe procedurat administrative të nevojshme për ta bërë një skemë të re plotësisht funksionale ekzistojnë tashmë dhe do të jenë të përshtatshme për arritjen e qëllimit, ose
  - se nëse ato nuk ekzistojnë ose janë konsideruar si të papërshtatshme, kërkesat shtesë që nevojiten mund të sigurohen në nivelin e nevojshëm për zbatim efektiv?
- A3.3 A është praktikë standarde të kryhet një kontroll për secilin projekt të ri legjislativ për të garantuar:
- se ekzistojnë tashmë burimet përkatëse, veçanërisht burimet njerëzore, për ta bërë një skemë të re plotësisht funksionale, ose
  - se nëse burimet nuk ekzistojnë, cilat burime do të jetë nevoja të sigurohen?
- A3.4 Gjatë verifikimit të tij, a kërkohet t'i kushtohet vëmendje e veçantë faktit nëse duhet përdorur dhe në çfarë mënyrash administrimi i kompjuterizuar në procesin e zbatimit?
- A3.5 Nëse po, a është praktikë standarde të kontrollohet efekti i përdorimit të sistemeve të kompjuterave tek zbatimi (për shembull, për rritjen apo uljen e kostove, apo për vonimin e fillimit të skemës deri kur janë plotësuar sistemi i kompjuterizuar dhe trajnimi përkatës)?

### **A4. Kontrollat e efektit**

#### ***Kostot dhe efekti ekonomik***

- A4.1 A janë hartuar akte nënligjore për të drejtuar përdorimin e verifikimit të kostove për projektet e reja legjislative?

A4.2 A i parashikojnë aktet nënligjore tipet e projekteve legjislativë për të cilat ia vlen të bëhet vlerësimi i kostos dhe, në veçanti duke përcaktuar rastet se kur duhet të përdoret ai?

A4.3 A janë vendosur procedura zyrtare për vlerësimin e efektit financiar të projekteve të reja legjislativë në buxhetin e qeverisë, në lidhje me kapitalin dhe kostot rrjedhëse dhe, në veçanti për kostot e personelit dhe ato organizative?

A4.4 A janë ndërtuar procedura zyrtare për vlerësimin e efektit financiar të projekteve të reja legjislativë në buxhetin e autoriteteve të tjera qeveritare (të tilla si pushteti lokal ose autoritetet e provincave)?

A4.5 A e kërkojnë rregulloret që vlerësimi i kostove të përfshijë edhe një vlerësim të:

- a) efektit financiar mbi ato organe të sektorit privat që kanë mundësi të ndikohen nga projektet e reja legjislativë, veçanërisht për kostot më të mëdha administrative dhe shpenzimet kapitale, dhe
- b) efektit financiar të tërthortë të legjislacionit të ri mbi sektorin privat, për shembull, mbi strategjitë e investimit dhe uljen e mundshme të taksave?

A4.6 Për rregulloret:

- a) A kërkojnë ato që vlerësimi i kostove të përfshijë një vlerësim të efektit të skemës që propozohet për sa i përket rritjes së kostove sociale në komunitetin më të gjerë?
- b) A japin ato udhëzime për kriteret që duhet të zbatohen për të përcaktuar nëse rritje të tilla do të jenë të pranueshme, ose për shembull, do të çojnë thjesht në ndryshime të pasyнуara në sjelljen e publikut? dhe
- c) A kërkojnë rregullat që të bëhet një vlerësim i pasojave afatshkurtra, afatmesme dhe afatgjata të legjislacionit të ri për punësimin?

A4.7 A janë ndërtuar procedura për t'i dhënë mundësi qeverisë të marrë vesh përmes një vlerësimi *ex post* nëse kostot e parashikuara kanë qenë realiste?

### ***Efiçenca***

A4.8 A kërkojnë rregulloret të kryhen kontrolle të posaçme për të vlerësuar nëse një skemë legjislativë do t'i arrijë apo jo objektivat e saj?

A4.9 Në veçanti, a është ndërtuar verifikimi në mënyrë të tillë që të kontrollojë:

- a) që skema do t'i arrijë objektivat e saj me kosto minimale, dhe
- b) nëse skema mund të çojë në efekte joproduktive ose në pasoja të pasyнуara ose të papërshtatshme?

A4.10 A përfshin verifikimi përgatitjen e një deklarimi të përfitimeve të pritshme të legjislacionit të ri (përfshirë edhe të dhënat sasiore), duke treguar veçanërisht mangësitë e ligjit ekzistues dhe se si do të ndihmojë skema e re për përmirësimin e situatës?

### ***Prakticiteti***

A4.11 A kërkohet që kontrollet të kryhen posaçërisht për të vlerësuar nëse një skemë e re e propozuar legjislativë do të:

- a) sigurojë përfitimet e synuara për ata që synohet të përfitojnë, dhe

b) plotësojë nevojat operacionale për administratën që do ta zbatojë atë?

- A4.12 A përfshin ky verifikim një shqyrtim të faktit nëse skema do të bëjë që administrata publike të bëjë teprime burokratike ose të zbatojë procedura të panevojshme e komplekse administrative?
- A4.13 A përfshin ky verifikim një shqyrtim nëse administrimi i skemës do të krijojë një mbingarkesë për sektorin privat për sa i përket procedurave komplekse të panevojshme ose të papërshtatshme (për shembull, për të marrë autorizim zyrtar) po do të përpunojë rregullore për pajtueshmërinë?
- A4.14 A përfshin ky verifikim një vlerësim nëse skema do të bëjë kërkesa për administratën publike ose sektorin privat të cilat nuk do të jenë efektive për sa i përket kostos, pra në kuptimin ekonomik, kërkesa të cilat nuk do të ishin në raport të drejtë me përfitimet që do të sjellë?
- A4.15 A përfshin ky verifikim një vlerësim të ndikimit të mundshëm të skemës, mbi ata të cilëve u drejtohet drejtpërdrejt dhe tërthorazi mbi palët e treta, për sa i përket shpenzimeve shtesë ose kufizimeve ose humbjes së përfitimeve apo të shanseve personale a ekonomike?
- A4.16 A përfshin ky verifikim një shqyrtim nëse skema mund të çojë në mundësi për praktika korruptive në administrimin e saj (për shembull, pagesat e paligjshme ndaj zyrtarëve për të marrë licenca)?
- A4.17 A përfshin ky verifikim një vlerësim të mundësisë së pranimit të skemës nga publiku me t'u bërë funksionale si edhe të mundësisë së përgjigjes ose reagimit të publikut për sa i përket ndryshimit në sjellje (ndryshim i synuar dhe i pasynuar)?

### **Zbatimi**

- A4.18 A është e nevojshme t'u jepet konsideratë e posaçme metodave me të cilat sigurohet përputhshmëria e legjislacionit dhe përcaktimit të:
- a) neneve që duhen për të garantuar zbatimin efektiv të skemës legjislative, dhe
  - b) burimeve njerëzore, institucionale, dhe financiare që do të duhen për ti vënë në fuqi metodën e përzgjedhur për zbatim?
- A4.19 A duhet të kryhet ndonjë kontroll i veçantë për të vlerësuar nëse metodat e propozuara për sigurimin e përputhshmërisë, për zbatimin e skemës legjislative dhe për gjykimin e mosmarrëveshjeve do të jenë efektive, të drejta, konsistente dhe të hapura në funksionimin e tyre?
- A4.20 A duhet të kryhet ndonjë kontroll i veçantë për të përcaktuar se metodat e propozuara për përputhshmërinë, zbatimin dhe gjykimin ka mundësi të kontrollojnë besimin dhe bashkëpunimin e atyre që preken dhe që janë brenda aftësive të tyre për t'i kryer?

## **B. ORGANIZIMI I HARTIMIT TË LIGJIT**

### **B1. Kuadri rregullator**

- B1.1 A ekzistojnë rregullore që parashikojnë procedurat dhe kërkesat që duhet të ndiqen për hartimin e legjislacionit? A janë rishikuar ato që prej miratimit ?
- B1.2 A janë këto rregullore të mbledhura bashkë në një instrument të vetëm rregullator (për shembull, në legjislacion, direktivë ose manual) që përdoret nga të gjithë hartuesit e legjislacionit?
- B1.3 A përshkruajnë këto rregullore procedura standarde që duhen ndjekur në procesin e hartimit dhe kërkesa standarde për formën, formatimin, stilin e draftit, dhe operimin e legjislacionit?
- B1.4 A ekziston ndonjë organ qeveritar (për shembull, ministër) përgjegjës për formulimin dhe përditësimin e këtyre procedurave dhe kërkesave, dhe për të garantuar se standardet e përbashkëta

të përcaktuara prej tyre ndiqen nga hartuesit e ligjit në ministritë e veçanta?

- B1.5 A përdoren listat rregullatore për këto qëllime, apo a janë hartuar ato?
- B1.6 A ekziston ndonjë organ gjyqësor ose parlamentar i ngarkuar në mënyrë të posaçme me verifikimin se standardet ndiqen në mënyrë konsistente në hartimin e legjislacionit?
- B1.7 A ekziston ndonjë organ i vetëm qeveritar (për shembull një ministër) i ngarkuar në mënyrë të posaçme për të mbikëqyrur kuadrin rregullator dhe/ose për të koordinuar programin e hartimit të akteve nënligjore të ndërmarra nga ministritë?

## **B2. Personeli hartues**

- B2.1 A njihet hartimi i ligjit si një aftësi e posaçme ligjore për të cilën çdo ministri ka nevojë kohë pas kohe dhe e cila kërkon cilësi të specializuara të cilat fitohen më së miri përmes trajnimit sistematik dhe përvojës aktuale?
- B2.2 A ka çdo organ qeveritar (ose a ka akses) i ngarkuar me përgatitjen e legjislacionit (për shembull, ministri) një numër të mjaftueshëm hartuesish të ligjit që kanë eksperiencën për të plotësuar këto nevoja?
- B2.3 A ka parlamenti (ose a ka akses në) një numër të mjaftueshëm hartuesish të ligjit (ose komisionesh apo anëtarësh) me përvojë për të plotësuar nevojat e hartimit me qëllim që të iniciojnë hartimin e legjislacionit ose përgatitjen e amendamenteve të ligjeve qeveritare?
- B2.4 A do të lehtësoheshin burimet e hartimit të legjislacionit nëse buxhetet e ministrive do të ofronin fonde të posaçme për punësimin e hartuesve të ligjit?
- B2.5 A janë ndërmarrë hapa për të garantuar se ata që janë angazhuar në hartimin e ligjit e kanë nivelin përkatës të eksperiencës dhe të trajnimit për të kryer detyrat e veçanta që u caktohen?
- B2.6 A do të kishte ndonjë avantazh nëse, në bazë të kushteve të shërbimit në qeveri, u jepet një njohje e veçantë shkathtësive të veçanta dhe ekspertizës së kërkuar për hartuesit e ligjeve? Në veçanti, a ekzistojnë shanse për hartuesit e ligjeve për t'u ngritur në detyrë ose për ndonjë avancim tjetër *në kapacitetin e tyre si hartues ligjesh*?
- B2.7 A janë vlerësuar periodikisht kompetenca dhe aftësia për hartimin e ligjit e zyrtarëve të angazhuar për hartimin e ligjit (për shembull, përmes vlerësimit të performancës)?
- B2.8 A marrin trajnim bazë për aftësitë dhe shprehitë e posaçme të nevojshme për hartimin e ligjit të gjithë ata që mund të pritet të merren me këtë aktivitet kaq special?
- B2.9 A mund të marrin hartuesit e ligjit trajnim për të rritur shkathtësitë e tyre kohë pas kohe?
- B2.10 A ekzistojnë masa që u mundësojnë personave që janë të rinj në çështjen e hartimit të ligjit të punojnë me ose nën mbikëqyrjen e nëpunësve më me përvojë për hartimin e ligjit?
- B2.11 A ekziston një politikë e njëjtë që të përcaktojë se kur mund të punësohen konsulentë ose ekspertë të tjerë jashtë shërbimit qeveritar për të përgatitur drafte të legjislacionit? A vlerësohen rregullisht përfitimet në kosto nga përdorimi i personave të tillë më shumë sesa hartuesit e ligjit nëpër ministri?
- B2.12 A janë hedhur hapa për të garantuar që konsulentë ose ekspertë të tillë janë hartues kompetentë ligjesh dhe me njohuri të plota në lidhje me kërkesat dhe standardet aktuale për përgatitjen e legjislacionit?
- B2.13 A monitorohet cilësia e punës e hartuesve të ligjit (të ministrisë ose të hartuesve të jashtëm) nga një nëpunës i lartë në ministri? Në veçanti, a verifikohen posaçërisht draftet individuale për

gabime në hartim përpara se ministria t'i konsiderojë ato të plota?

B2.14 A janë hartuesit e ligjit në ministri në dispozicion të komisioneve parlamentare ose të komisioneve të ngjashme për të shpjeguar ose sqaruar legjislacionin me të cilin hartuesit kanë punuar? A i është bërë disponueshmëria e tyre e njohur sa duhet këtyre organeve?

### **B3. Instrumentet për verifikimin e drafteve**

B3.1 A janë në përdorim ose hartuar instrumente zyrtare për të ndihmuar në vlerësimin e drafteve të legjislacionit (për shembull, lista kontrolli në lidhje me përmbajtjen ose standardet e cilësisë)?

B3.2 A ekziston ndonjë organ qeveritar përgjegjës për studimin e përvojës së vendeve të tjera në përdorimin sistematik të kontrollit të hartimit të legjislacionit dhe në krijimin e instrumenteve të përshtatshme për përdorim lokal?

B3.3 Në veçanti, a janë përdorur ose a është duke u menduar të përdoren modelimi, algoritmet, grafiket, ose analizat e ecurisë kritike në përgatitjen e legjislacionit?

B3.4 A ekzistojnë udhëzime zyrtare për përdorimin e legjislacionit nga vende të tjera ose si model për politikëbërësit ose si një precedent legjislativ për hartuesit e ligjit?

### **B4. Përdorimi i teknologjisë kompjuterike**

B4.1 A ka ndonjë politikë qeveritare për përdorimin e plotë të teknologjisë së kompjuterizuar në procesin hartues?

B4.2 A është i pajisur me kompjuter personal për përdorim ekskluziv çdo hartues i ligjit me qëllim që draftet të shkruhen drejtpërdrejt në kompjuter?

B4.3 A përdorin të gjithë hartuesit e ligjit të njëjtën paketë për përpunimin e tekstit? A është ky një program standard apo janë duke u hedhur hapa që të krijohet një program i posaçëm për t'u përdorur për hartimin e ligjit?

B4.4 A është në përdorim apo a është krijuar një bazë të dhënash zyrtare elektronike e legjislacionit në fuqi në të cilën hartuesit mund të kenë akses online për të kërkuar ligjet që preken nga ndryshimet ose precedentët?

B4.5 Në mungesë të një baze zyrtare të dhënash, a kanë hartuesit e ligjit akses online në një bazë të dhënash të legjislacionit që lidhet me përgjegjësitë dhe funksionet e ministrisë së tyre?

B4.6 A përdorin zyrat qeveritare të shtypit pajisje të kompjuterizuara dhe moderne botimi?

B4.7 A është e mundur teknikisht që hartuesit e ligjit t'i japin zyrës së shtypit qeveritar tekstin e përgatitur në një formë (për shembull, disketë, ose online) që bën të mundur që legjislacioni të printohet pa përpunime të mëtejshme të tekstit?

### **B5. Procedurat e konsultimit**

B5.1 A janë hartuar rregullore që parashikojnë:

- a) procedura standarde sipas së cilave duhet të kryhen konsultimet me personat që preken, tu jepen informacione këtyre personave dhe si, dhe brenda cilave afate kohore duhen dhënë dhe shqyrtuar përgjigjet e tyre?
- b) se si do të mund që këto konsultime të bëhen efektive, të drejta dhe të hapura? dhe
- c) se si do të monitorohet përputhshmëria me procedurat e konsultimit dhe, në rastet kur ato janë të detyrueshme, si do të bëhet zbatimi i tyre?

- B5.2 A janë bërë rregullime zyrtare për t'i dhënë mundësi publikut të gjerë për të komentuar mbi propozimet legjislative ose projekt ligjet, në veçanti duke specifikuar si do të tërhiqet vëmendja e publikut drejt propozimeve legjislative dhe se si do të kërkohen, jepen dhe shqyrtohen përgjigjet e publikut?
- B5.3 A janë përdorur grupet e këshillimit, të përhershme ose të përkohshme, për të ndihmuar në hartimin e ligjeve të reja për fusha të veçanta?
- B5.4 A janë bërë rregullime zyrtare për të bërë të mundur që procedurat e konsultimit të ndiqen sipas legjislacionit të iniciuar nga parlamenti?
- B5.5 A e parashikojnë rregulloret që justifikimet e dërguara në këshillin e ministrave dhe parlament duhet të përfshijnë një deklaram në lidhje me organet që janë konsultuar gjatë procesit të hartimit të legjislacionit?

## **C. HARTIMI I LEGJISLACIONIT PARËSOR**

### ***C1. Programi legjislativ dhe kalendari kohor***

- C1.1 A miraton qeveria (përmes këshillit të ministrave) një program zyrtar të ligjeve që duhet të përgatiten për shqyrtim në sesionet e ardhshme të parlamentit?
- C1.2 A ka qeveria një procedurë zyrtare (për shembull, mendimin e një komisioni të Këshillit të Ministrave) për të vendosur, për shkak të kërkesave kontradiktore të ministrave, se cilave projekte legjislative duhet t'u jepet përparësi në programin tjetër legjislativ?
- C1.3 A parashikon qeveria një kalendar kohor vjetor për përcaktimin e prioritetëve legjislative dhe për marrëveshjen për programin e ardhshëm legjislativ?
- C1.4 A i përcakton programi legjislativ përparësitë legjislative të qeverisë për sesionet e ardhshme parlamentare, të cilat do të mund të ndryshohen vetëm për shkak të rasteve urgjente?
- C1.5 A mbulon ky program një periudhë mjaftueshmërisht të gjatë (për shembull, të paktën një vit) për të garantuar ministritë e interesuara të planifikojnë hartimin e legjislacionit të tyre në mënyrë efektive?
- C1.6 A i miraton ose i konfirmon qeveria kolektivisht, përmes Këshillit të Ministrave, objektivat e politikave për secilin projekt të ri legjislativ para se të lejohet të fillojë procesi i hartimit?
- C1.7 A është përcaktuar në programin legjislativ një kalendar kohor për përgatitjen e ligjeve? A koordinohet zbatimi i tij nga qeverisja qendrore dhe a monitorohet përputhshmëria e tij nga qeveria qendrore?
- C1.8 A miratohet zyrtarisht nga ministri çdo ligj i hartuar në ministri pasi drafti ka përfunduar?
- C1.9 A duhet që çdo ligj i plotë të dorëzohet në qeveri dhe të miratohet kolektivisht nga qeveria (për shembull, nga Këshilli i Ministrave) përpara sesa ai të çohet në parlament?
- C1.10 A bëhet ndonjë krahasim zyrtar (për shembull, nga një komision i Këshillit të Ministrave) midis objektiveve të politikave të miratuara fillimisht dhe draftit legjislativ përfundimtar për të përcaktuar që të dy ata janë të përputhur, përpara se drafti të miratohet nga qeveria?
- C1.11 A shoqërohet çdo ligj që dorëzohet në Këshillin e Ministrave me materiale shpjeguese të detajuara (për shembull një justifikim) që përshkruajnë objektivat legjislative dhe mekanizmat e përdorur dhe që tregojnë verifikimet e kryera (shih seksionet A & E të kësaj liste kontrolli)?
- C1.12 A vendoset kolektivisht nga qeveria (për shembull, nga Këshilli i Ministrave) koha se kur një ligj



do të çohet në parlament?

- C1.13 A i ofron qeveria parlamentit njoftim të mjaftueshëm për çuarjen e ligjeve të veçantë për të bërë të mundur që parlamenti të programojë veprimtaritë e tij legjislative në mënyrë efektive?
- C1.14 A njihen plotësisht me objektivat dhe skemën legjislative personat përgjegjës për paraqitjen e ligjit në parlament në emër të qeverisë dhe për prezantimin e mbrojtjen e tij?
- C1.15 A janë parashikuar rregullore përkatëse që bëjnë të mundur që hartuesit e një ligji t'u ofrojnë sqarimet e nevojshme për hartimin e ligjit atyre personave përgjegjës si përpara ashtu edhe gjatë shqyrtimit parlamentar?

## **C2. *Procesi i hartimit***

- C2.1 A ekzistojnë rregulla të përcaktuara qartë brenda ministrive për përzgjedhjen dhe caktimin e hartuesve të ligjit, të cilët të kenë përgjegjësinë për hartimin e ligjeve të ministrisë?
- C2.2 A është praktikë të përfshihen në përgatitjen e një ligji mbi një çështje komplekse e të gjerë zyrtarë me aftësi të veçanta në atë fushë si edhe zyrtarë të specializuar për hartimin e ligjit (për shembull, duke formuar një "ekip për ligjin" ose një grup pune brenda ministrisë përgjegjëse ose në ndonjë mënyrë tjetër)?
- C2.3 A ekzistojnë udhëzime të qarta (përfshirë edhe ato mbi shpenzimet e lejueshme) që të tregojnë se kur ministrinë e veçanta mund të angazhojnë persona të jashtëm dhe, veçanërisht nga jashtë qeverisë, në punën me një ekip që punon për një ligj?
- C2.4 A është përcaktuar në ministri ndonjë kalendar kohor për përfundimin e çdo ligji? Në veçanti, a merret parasysh koha që nevojitet për përgatitjen, shqyrtimin dhe konsultimin mbi numrin e drafteve që ka të ngjarë të kërkohen për një legjislacion të veçantë?
- C2.5 A është një praktikë standarde për një grup pune për ligjet të përpunojë objektivat, metodologjinë dhe skemën e një legjislacioni të ri dhe, veçanërisht të zgjidhë problemet e mundshme operacionale, *përpara* se të ndërmerret puna sistematike për hartimin e tekstit të ligjit?
- C2.6 Pas përcaktimit të objektivave, metodologjisë dhe skemës, a i jepet hartuesit të ligjit përgjegjësi e plotë për përgatitjen e tekstit të projekt ligjit, për t'ia dhënë për shqyrtim grupit të punës ose zyrtarët e ministrisë?
- C2.7 A ekzistojnë udhëzime të qarta (përfshirë edhe ato mbi shpenzimet e lejueshme) që të tregojnë se kur, në ç'fazë dhe me ç'mjete grupi i punës i ligjit mundet ose duhet të konsultohet me ministrinë e tjera për përmbajtjen e ligjit?
- C2.8 A ekzistojnë udhëzime të qarta për kohën kur dhe nga kush mundet ose duhet të kërkohen komente nga grupet e interesit ose ekspertët jashtë qeverisë mbi projekt ligje të ndryshme? A kërkojnë këto udhëzime të përcaktohet një afat kohor brenda të cilit duhet të bëhen komentet e kërkuara?
- C2.9 Në veçanti, a ekzistojnë udhëzime të qarta në lidhje me rrethanat në të cilat teksti i projekt ligjit duhet të trajtohet si konfidencial vetëm për qeverinë dhe në lidhje me personin që mund të autorizojë personat jashtë qeverisë për të komentuar mbi draftin para se ai të çohet në parlament, si dhe për kushtet e këtij autorizimi?
- C2.10 A janë dhënë direktiva standarde në lidhje me përgjegjësit për shqyrtimin e tekstit të drafteve legjislative për gabime në përmbajtje ose në prezantim apo shtypje? Për shembull, a është e qartë se kush është përgjegjës për korrektimin e të gjitha versioneve të ligjit, përfshirë këtu edhe atë që përfundimisht e ka miratuar parlamenti?
- C2.11 A ka ndonjë procedurë me të cilën parlamenti ose grupet politike në parlament të mund të

shqyrtojnë dhe të komentojnë mbi (a) skemën politike dhe legjislativë të ligjit të propozuar dhe/ose (b) formën, strukturën ose hartimin e vetë ligjit përpara se ai të dërgohet në parlament?

### **C3. Shqyrtimi parlamentar i legjislacionit parësor**

- C3.1 A u është dhënë anëtarëve të parlamentit kohë e mjaftueshme për studimin e përmbajtjes së ligjit dhe për konsultimin e palëve të interesuara përpara se të bëhet shqyrtimi i parë parlamentar? Në veçanti, a e parashikojnë këtë gjë rregullat procedurale të parlamentit?
- C3.2 A është ofruar informacion i mjaftueshëm shpjegues (p.sh. justifikimi) bashkë me ligjin në momentin kur ai dërgohet për shqyrtim në parlament? A ka udhëzime standarde se çfarë duhet të përfshijë ky informacion dhe kush është përgjegjës për përgatitjen e tij?
- C3.3 A janë publikuar këto justifikime ose a u janë vënë në dispozicion anëtarëve të publikut (ose për të studiuar ligjin ose kur legjislacioni ka hyrë në fuqi)?
- C3.4 A kanë anëtarët e parlamentit ndihmë dhe këshillim të mjaftueshëm ligjor (për shembull, nga sekretariati i tij) për ta pasur të mundur të shqyrtojnë ligjin efektivisht në parlament dhe veçanërisht për përmbajtjen dhe mangësitë ekzistuese të ligjit që ligji i ri kërkon të reformojë ose amendojë?
- C3.5 A u japin mundësi deputetëve rregullat procedurale të parlamentit të marrin të dhëna nga zyrtarë të ministrisë, nga ekspertë të jashtëm ose anëtarë të informuar të publikut kur shqyrtojnë një ligj?
- C3.6 A është në dispozicion për deputetët ndihma dhe këshillimi për hartimin e ligjit (për shembull nga sekretariati i tij) për t'i mbështetur ata që t'i hartojnë vetë amendamentet ose ligjet për në parlament?
- C3.7 Kur amendamentet për ligjet qeveritare propozohen nga parlamenti, a ekzistojnë rregullime të përshtatshme për të garantuar se amendamentet janë hartuar në mënyrë konsistente me objektivat dhe gjuhën e ligjit?
- C3.8 A i parashikojnë rregullat procedurale të parlamentit afatet kohore brenda të cilave duhet të njoftohen amendamentet e ligjeve qeveritare përpara se ato të dërgohen për shqyrtim në parlament? A janë këto rregulla të mjaftueshme për të garantuar që qeveria dhe deputetët të shqyrtojnë implikimet e një amendamenti?
- C3.9 A i mundësojnë qeverisë rregullat procedurale të parlamentit shanse të mjaftueshme për të shqyrtuar ligjet dhe amendamentet e paraqitura nga deputetët dhe për të raportuar qëndrimet e saj zyrtarisht në parlament?
- C3.10 Nëse parlamenti shqyrton një ligj të propozuar me iniciativën e vet, a ekzistojnë procese zyrtare për të garantuar që parlamenti, gjatë përgatitjes së ligjit është bërë i ndërgjegjshëm se, për shembull, në rast të kufizimeve financiare dhe operacionale të qeverisë, çfarë veprimi legjislativ duhet të marrë parasysh?
- C3.11 A ekzistojnë mekanizma zyrtarë përmes së cilave ligjet ose amendamentet e iniciuara nga parlamenti mund t'i nënshtrohen verifikimeve të efektit, të ngjashme me ato që ishin përdorur nga qeveria për ligjin origjinal?
- C3.12 A është praktikë standarde që zyrtarët e ministrisë hartuese (veçanërisht, për hartuesit e ligjit) të monitorojnë së çfarë bëhet me ligjin e tyre në parlament?
- C3.13 Nëse qeveria del në përfundimin se një ligj ose një amendament parlamentar, ka nevojë të ndryshohet para se të shkojë në parlament, a e lejojnë rregullat procedurale të parlamentit ministrinë hartuese të parashtrijë amendamentin e vet?

#### **C4. Formalitetet**

- C4.1 A i identifikojnë amendamentet që ndryshojnë legjislacionin ekzistues saktësisht vendet ku legjislacioni është amenduar dhe a i specifikojnë ato saktësisht ndryshimet? Në veçanti, a janë bërë amendamentet në formën e ndryshimeve specifike ose të shitesave ose të heqjeve në *tekstin* e legjislacionit?
- C4.2 A ekzistojnë rregulla standarde që përshkruajnë sesi të trajtohen nenet legjislative që kanë efekte financiare (për shembull, për shpenzime ose taksa)?
- C4.3 A ekzistojnë rregulla standarde që përshkruajnë se *kur* hyn në fuqi legjislacioni, nëse kjo nuk është bërë shprehimisht në vetë ligjin?
- C4.4 A ekzistojnë rregulla standarde ligjore që rregullojnë përdorimin e urdhrave qeveritare për qëllimin e hyrjes në fuqi të legjislacionit dhe për mënyrat me të cilat do të ushtrohet kjo fuqi?
- C4.5 A parashikojnë rregullat standarde ligjore që legjislacioni shfuqizohet automatikisht nëse nuk hyn në fuqi brenda një afati kohor të përcaktuar?

#### **D. HARTIMI I LEGJISLACIONIT DYTËSOR**

##### **D1. Dhënia e autoritetit për të hartuar legjislacionin dytësor**

- D1.1 A ekzistojnë qëllime ose çështje të pranura për të cilat legjislacioni dytësor duhet të përdoret ose jo për të zbatuar legjislacionin parësor? Në veçanti, a kërkojnë rregullimet se çështjet që mund të kenë një përmbajtje të rëndësishme ose të debatueshme duhet të trajtohen nga legjislacioni parësor?
- D1.2 Kur nevojitet legjislacion dytësor për të zbatuar legjislacionin parësor, a është një praktikë standarde të diskutohet se kush duhet ta bëjë këtë dhe të specifikohet në legjislacionin parësor organi që do ta bëjë këtë?
- D1.3 A përcakton ligji i përgjithshëm kufij ose kushte që rregullojnë ushtrimin nga organet qeveritare të kompetencave të tyre për të hartuar legjislacion dytësor?
- D1.4 A është praktikë standarde për legjislacionin parësor të vendosë kufij specifikë mbi ushtrimin e kompetencës për të hartuar ligje dytësore (për shembull, duke kufizuar përdorimin e tij për qëllime të përcaktuara specifikisht)? Në veçanti, a e parashikon legjislacioni parësor se cilat janë procedurat e detyrueshme normale që duhet të kryhen kur hartohet legjislacion dytësor (për shembull, në lidhje me konsultimet)?
- D1.5 A është praktikë standarde që gjatë hartimit të legjislacionit parësor të kontrollohet nëse është dhënë autoritet i mjaftueshëm ligjor për të garantuar që legjislacioni dytësor që mund të duhet është hartuar?
- D1.6 A kryhen kontrole gjatë hartimit të legjislacionit parësor për të përcaktuar se delegimi i kompetencës për të hartuar legjislacion dytësor është kushtetues?
- D1.7 Kur legjislacioni parësor duhet të gjejë zbatim përmes legjislacionit dytësor për ta bërë efektive skemën legjislative, a kryhen kontrole për të garantuar që legjislacioni parësor nuk do të hyjë në fuqi përpara se i gjithë legjislacioni dytësor i kërkuar të jetë hartuar?

##### **D2. Hartimi i legjislacionit dytësor**

- D2.1 A parashikojnë rregullat se cilët janë personat që vendosin se legjislacioni dytësor duhet të përgatitet për qëllimet e zbatimit të legjislacionit parësor, kush i drejton hapat zyrtarë që duhet të ndiqen kur përgatitet ky legjislacion dytësor dhe se cilët persona e përcaktojnë se cilat raste

kërkojnë miratimin kolektiv të qeverisë?

- D2.2 A janë personat brenda ministrisë që ka përgatitur politikën për legjislacionin parësor të njëjtët persona që janë përfshirë edhe në përcaktimin e përmbajtjes së legjislacionit dytësor? A përfshihet hartuesi i ligjit në këtë fazë?
- D2.3 A kryhet hartimi i legjislacionit dytësor brenda ministrisë zakonisht nga një hartues ligji? A merren hapa për të mbështetur punën që duhet të bëhet, nëse është e mundur, nga hartuesi i ligjit që përgatiti legjislacionin parësor?
- D2.4 A i parashikojnë rregullat se cilat janë organet e qeverisë (brenda ministrisë në fjalë ose brenda ministrive të tjera) të cilat duhet të përfshihen në diskutimin e legjislacionit dytësor?
- D2.5 A ekziston ndonjë kërkesë e përcaktuar në rregullat në lidhje me konsultimet me palët e prekura ose me grupet e posaçme të interesit?
- D2.6 A e parashikojnë rregullat fazën e hartimit të ligjit kur duhet të kryhen konsultime të brendshme dhe publike dhe si duhet të organizohen ato?
- D2.7 Në veçanti, a është menduar nëse legjislacioni specifik dytësor i rëndësishëm për publikun duhet të bëhet publik për t'u komentuar nga publiku brenda një kohe të caktuar përpara se të bëhet zyrtar?
- D2.8 A i parashikojnë rregullat kërkesat zyrtare që duhet t'i respektojnë hartuesit e ligjit kur përgatisin legjislacion dytësor, duke kërkuar në veçanti të bëhen kontrole për të përcaktuar nëse:
- ekziston autoriteti ligjor i nevojshëm për të përgatitur legjislacionin dytësor të kërkuar;
  - përmbajtja e legjislacionit të propozuar është në përputhje me legjislacionin parësor të cilin ai zbaton; dhe
  - legjislacioni dytësor nuk bie në konflikt me ligjet e tjera?
- D2.9 A përcaktojnë rregullimet konvencione, veçanërisht në lidhje me formën dhe stilin, të cilat hartuesit e ligjit duhet t'i venë në zbatim kur merren me përgatitjen e legjislacionit dytësor?
- D2.10 A i parashikojnë rregullat rrethanat kur duhet të dorëzohet për miratim në këshillin e ministrave legjislacioni dytësor dhe dokumentacioni mbështetës?
- D2.11 A i specifikojnë rregullat veprimet zyrtare përmes së cilave një instrument në formë drafti bëhet një ligj efektiv (për shembull, firma e një ministri e ndjekur nga publikimi në gazetën zyrtare)?

### **D3. Procedurat pas hartimit të legjislacionit dytësor**

- D3.1 A i është dhënë përgjegjësi ndonjë organi (ose kolektivisht për qeverinë, ose brenda ministrive të veçanta) për kryerjen e një kontrolli përfundimtar, pasi është hartuar legjislacioni dytësor, për vlefshmërinë, formën, përcaktimin e kompetencave të organit, veçanërisht në lidhje me instrumentet që kanë mangësi?
- D3.2 A ekziston ndonjë kërkesë ligjore sipas së cilës i gjithë legjislacioni dytësor duhet të regjistrohet në mënyrë të centralizuar, dhe që të specifikojë se si duhet të mbahet regjistri, nga kush, dhe se çfarë detajesh duhet të regjistrohen?
- D3.3 A ekziston ndonjë organ qeveritar i ngarkuar me grumbullimin dhe publikimin e një indeksi zyrtar ose të një udhëzimi të ngjashëm për të gjithë legjislacionin dytësor të hartuar dhe që është në fuqi dhe që ka lidhje me legjislacionin parësor specifik?
- D3.4 A parashikojnë rregullat se sa kohë pas hartimit duhet të publikohet legjislacioni dytësor?

D3.5 A ekziston ndonjë kërkesë ligjore që, me përjashtime të veçanta, legjislacioni dytësor duhet fillimisht të publikohet me qëllim që të jetë efektiv? Nëse jo, a imponon ligji kufizime mbi përdorimin e legjislacionit dytësor përpara se ai të publikohet?

#### **D4. Veprimi parlamentar**

D4.1 A parashikojnë rregullat se legjislacioni dytësor i posaçëm duhet të dërgohet ose raportohet në parlament (për shembull, për shkak të përmbajtjes së tij politike ose natyrës kontradiktore) dhe si, dhe brenda cila afateve kohore duhet të bëheshin komunikime të tilla?

D4.2 A ekzistojnë kërkesa standarde që të përcaktojnë se kur duhet të konfirmohet ose rrëzohet nga parlamenti legjislacioni dytësor?

D4.3 A përmbajnë rregullat procedurale të parlamentit nene për shqyrtimin, debatimin e legjislacionit dytësor me iniciativën e parlamentit?

D4.4 A ka parlamenti kompetencë të amendojë legjislacionin dytësor të hartuar nga qeveria? A parashikojnë rregullat procedurale mënyrën sesi duhet të propozohen dhe shqyrtohen këto amendamente dhe a lejojnë ato shanse për reagimet e qeverisë?

D4.5 Nëse parlamenti e ka kompetencën për të iniciuar legjislacion dytësor, a janë përgatitur instrumentet nga hartues ligjorë me eksperiencë?

D4.6 A ekziston ndonjë procedurë përmes së cilës instrumentet e iniciuara nga parlamenti të dorëzohen në ministrinë përkatëse për komente përpara se të jepet miratimi parlamentar? A ekziston ndonjë procedurë që të garantojë se kostoja dhe efekti ekonomik i legjislacionit janë marrë plotësisht në konsideratë gjatë procesit të hartimit?

D4.7 A ka formuar parlamenti ndonjë komision për të analizuar mënyrën me të cilën ushtrohen kompetencat e hartimit të legjislacionit dytësor? A i kanë dhënë rregullat e procedurës kompetenca efektive atij organi?

### **E. VERIFIKIMET E POSAÇME TË DRAFTEVE LEGJISLATIVE**

*Verifikimet që vijojnë janë përdorur në vendet anëtare të OECD-së në procesin e hartimit të legjislacionit për të përmirësuar cilësinë e tij si një instrument që përmban ligje të qarta, konsistente, të plota dhe të zbatueshme. Ato duhet të përdoren nga çdokush që është përgjegjës për hartimin e legjislacionit - edhe parësor edhe dytësor. Po ashtu, ato duhet të jenë karakteristika standarde të procesit të hartimit të legjislacionit nga qeveria dhe nga parlamenti si për legjislacionin ashtu edhe për amendamentet e legjislacionit që ndërmerren.*

#### **E1. Përputhja me kushtetutën**

E1.1 A janë tekstet e drafteve të ndryshme të legjislacionit (parësor e dytësor) të verifikuara në mënyrë të posaçme gjatë fazave të hartimit për sa i përket përputhjes me kërkesat e kushtetutës?

E1.2 Në veçanti, a verifikohet posaçërisht përputhja me nene të veçanta të kushtetutës (për shembull, me ato që lidhen me të drejtat e njeriut ose të drejtat e qytetarëve)?

E1.3 A ka marrë parlamenti masa zyrtare për të verifikuar se draftet legjislative ose amendamentet e propozuara nga to janë në përputhje me kërkesat e kushtetutës?

E1.4 A parashikojnë rregullimet se si dhe kujt duhet t'i njoftohen faktet dhe rezultatet e këtij verifikimi si edhe aksionin pasues që mund të ndërmerret nëse zbulohen vështirësi?

## **E2. Përputhja me ligjet dhe sistemin ligjor ekzistues**

- E2.1 A është bërë ndonjë kontroll i posaçëm, përpara se të fillojë hartimi i legjislacionit, për të konfirmuar se kërkohet një legjislacion i ri dhe se çështja nuk mund të zgjidhet me ligjet ekzistuese ose me mjete të tjera që nuk kërkojnë legjislacion?
- E2.2 A është verifikuar posaçërisht teksti i çdo drafti të legjislacionit të veçantë (parësor ose dytësor) nga hartuesit e ligjit gjatë fazës hartuese për konsistencë me ligjin ekzistues, me strukturat dhe procedurat ligjore?
- E2.3 A janë bërë rregullime zyrtare për të verifikuar që:
- drafti i ligjit është në përputhje me kërkesat ekzistuese ligjore që përcaktojnë standardet mjedisore, dhe
  - zbatimi i legjislacionit të propozuar do të plotësojë standardet kombëtare për mbrojtjen e mjedisit?
- E2.4 A parashikojnë rregullat që hartuesit e ligjit duhet të bëjnë hetime të posaçme në përfundim të hartimit të legjislacionit të ri për të vendosur dhe bërë parashikime legjislative për:
- të gjitha nenet e ligjit ekzistues që duhet të shfuqizohen ose amendohen, dhe
  - dispozitat kalimtare që nevojitet të përfshihen me qëllim që të garantojnë vazhdimësinë ligjore midis legjislacionit të ri dhe ligjit ekzistues?

## **E3. Përafrimi me legjislacionin e BE-së**

- E3.1 A është hartuar ndonjë metodologji e posaçme për kontrollin e përputhjes së legjislacionit ekzistues ose të ri me legjislacionin e BE-së?
- E3.2 A propozojnë rregullimet llojet e legjislacionit (në hierarkinë e instrumenteve legjislative) që duhet t'i nënshtrohen këtij verifikimi dhe kriteret që duhen zbatuar kur kontrollohet përputhja e tyre me legjislacionin e BE-së?
- E3.3 A e identifikojnë qartë rregullimet organin ose organet përgjegjëse për filtrimin e drafteve të cilat do t'i nënshtrohen kontrollit të përmbushjes së kriterëve?
- E3.4 A e parashikojnë rregullat procedurën që duhet ndjekur nëse legjislacioni konsiderohet se nuk përputhet në disa aspekte me ligjet e BE-së? A e identifikojnë ato autoritetin i cili duhet të japë vendimin përfundimtar mbi veprimin që duhet të merret në lidhje me projekt ligjin që është i papajtueshëm me ligjet që zbatohen në BE-së?
- E3.5 A parashikojnë rregullat që i gjithë legjislacioni në formë drafti i dërguar në Këshillin e Ministrave duhet të shoqërohet me një deklarami i cili të konfirmojë faktin se verifikimi është kryer për këtë qëllim dhe të përcaktojë përmasat e përputhjes së legjislacionit me ligjet e BE-së (për shembull, një certifikatë përputhjeje)?
- E3.6 A janë bërë rregullimet zyrtare për të garantuar se draftet legjislative ose amendamentet e propozuara nga parlamenti janë verifikuar për përputhshmërinë e tyre me legjislacionin e BE-së?

## **E4. Përputhja me detyrimet e tjera ndërkombëtare**

- E4.1 A janë parashikuar rregullime të posaçme formale për të verifikuar se draftet legjislative janë në përputhje me Konventën Europiane të të Drejtave të Njeriut?
- E4.2 A janë parashikuar rregullime të posaçme formale për të verifikuar se draftet legjislative janë në përputhje me detyrime të tjera që rrjedhin nga traktate, ose që kanë hyrë në fuqi, ose do të hyjnë

në fuqi, të cilat mund të ndikojnë mbi çështje të veçanta të mbuluara nga legjislacioni (për shembull, traktatet mbi çështjet e mjedisit, Konventat e ILO-s)?

- E4.3 A i identifikojnë rregullimet ligjore personat ose organet përgjegjëse për kryerjen e këtij verifikimi? A i rekomandojnë ato procedurat që duhen ndjekur, në veçanti në rastet kur janë mospërputhje?
- E4.4 A parashikojnë rregullimet ligjore që të gjitha draftet legjislative të dërguara në Këshillin e Ministrave duhet të shoqërohen me një deklaram i cili të konfirmojë faktin se verifikimi është kryer për këtë qëllim dhe se legjislacioni përputhet me traktatin?
- E4.5 A janë parashikuar rregullime të posaçme formale për të garantuar se draftet legjislative ose amendamentet e propozuara nga parlamenti janë verifikuar për përputhjen me traktatin?

#### **E5. Kontrollat për zbatimin**

- E5.1 A kryejnë hartuesit e ligjit kontrole sistematike për të përcaktuar se draftet legjislative përmbajnë të gjitha dispozitat e kërkuara për të garantuar që skema të zbatohet plotësisht dhe administrimi i saj të bëhet plotësisht funksionale?
- E5.2 A i është kushtuar vëmendje e posaçme metodave me të cilat do të sigurohet përputhja e legjislacionit të ri dhe do të përcaktohen dispozitat ligjore të nevojshme për të garantuar zbatimin efektiv të skemës legjislative?
- E5.3 A duhet të kryhet ndonjë kontroll i posaçëm për të vlerësuar nëse metodat e propozuara për garantimin e përputhshmërisë, për zbatimin e skemës legjislative, dhe për zgjidhjen e mosmarrëveshjeve janë efektive, të drejta, konsistente dhe të hapura, transparente në veprimin e tyre?
- E5.4 A duhet të kryhet ndonjë kontroll i posaçëm për të përcaktuar se metodat e miratuara për përputhshmërinë, zbatimin dhe zgjidhjen e mosmarrëveshjeve kanë mundësi të sjellin besimin dhe bashkëpunimin e atyre që preken dhe janë brenda kapacitetit të tyre të përputhshmërisë?
- E5.5 A u kërkohet hartuesve të ligjit të kontrollojnë posaçërisht që gjuha legjislative e përdorur lehtëson funksionimin e gjykatave në gjykimin e çështjeve dhe në zgjidhjen e mosmarrëveshjeve që lindin si rezultat i skemës legjislative?
- E5.6 A duhet të kryhet ndonjë kontroll i posaçëm për të përcaktuar burimet njerëzore, institucionale dhe financiare që do të kërkohen për të zbatuar draftin dhe, shkallën në të cilën këto burime mund të kenë nevojë të përmirësohen dhe si do të arrihet kjo gjë?
- E5.7 A janë bërë rregullime zyrtare për të garantuar se ky verifikim është kryer gjithashtu edhe për legjislacionin e iniciuar nga parlamenti ose për amendamentet e legjislacionit, pavarësisht nëse janë propozuar nga qeveria apo parlamenti?
- E5.8 A parashikojnë rregullimet ligjore që justifikimet e dërguara në Këshillin e Ministrave dhe në parlament duhet të përfshijnë edhe njoftimin formal se ky verifikim është kryer?

#### **E6. Kontrollat për formën ligjore, qartësinë dhe kuptueshmërinë**

- E6.1 A i parashikojnë rregullimet ligjore format standard që hartuesit e ligjit pritët të ndjekin kur hartojnë legjislacionin, veçanërisht në lidhje me:
- a) formën e instrumenteve legjislative parësore dhe dytësore (për shembull, të një titulli, dhe mënyrën e numërimit të instrumenteve dhe e ndarjes dhe e numërimit të ndarjeve të brendshme);
  - b) formulën hapëse dhe mbyllëse, parashikimet teknike që merren me objektivat, veprimin dhe

zbatimin;

- c) vendosjen e llojeve të veçanta të dispozitave legislative (për shembull, ato që lidhen me zbatimin, shfuqizimin ose amendimin e legjislacionit tjetër, dispozitat kalimtare);
- d) format që duhen përdorur për tipe të caktuara të dispozitave legislative (për shembull, dispozita penale, amenduese, shfuqizuese); dhe
- e) formatimin dhe stilet e printimit?

- E6.2 A parashikojnë rregullimet ligjore praktika standarde hartimi të cilat duhet të ndiqen për hartimin e tekstit të legjislacionit (për shembull, struktura legislative, stili i të shkruarit, terminologjia, përkufizimet, konsistenca e brendshme dhe shmangia e paqartësisë)?
- E6.3 A janë bërë rregullime formale për të garantuar që hartuesit e ligjeve, si ata në qeveri ashtu edhe ata që i shërbejnë parlamentit, ndjekin të njëjtat forma standarde dhe të njëjtat praktika standarde për hartimin e legjislacionit?
- E6.4 A ka përcaktuar qeveria një politikë zyrtare sipas së cilës legjislacioni duhet:
- a) të hartohet në një mënyrë të tillë që të jetë i lehtë për t'u kuptuar dhe për të punuar me të;
  - b) të jetë i qartë në mënyrën se si është paraqitur përmbajtja e tij;
  - c) të shmangë termat e panevojshëm ligjorë; dhe
  - d) të jetë shkruar në gjuhën e përdorimit standard të publikut që preket nga ai legjislacion?
- E6.5 A janë parashikuar rregullime ligjore formale për të kryer verifikime sistematike që i gjithë legjislacioni i ri i plotëson këto standarde?
- E6.6 A inkurajohen hartuesit e ligjit të bien dakord për konvencionet që janë hartuar posaçërisht për të venë në veprim këto objektiva?
- E6.7 A i është dhënë ndonjë organi përgjegjësia për të përcaktuar se si mund të përmirësohet cilësia e hartimit të legjislacionit, në veçanti në formulim dhe stil, me qëllim që legjislacioni të bëhet më i aksesueshëm?

## **E7. Kontrollat e politikave pas hartimit**

*Përpunimi i propozimeve të politikave gjatë procesit të hartimit të legjislacionit mund të prodhojë një skemë legislative e cila mbulon një gamë të gjerë çështjesh, ose të parashikojë rregullime ligjore më komplekse sesa ishin parashikuar më parë. Në këto rrethana, verifikimet e nivelit të dytë mund të jenë të përshtatshme pasi është përfunduar projekti. Po ashtu, këto verifikime mund të jenë të nevojshme për qëllimet e plotësimit të justifikimit që rregullisht shoqëron legjislacionin parësor.*

*Në veçanti, kontrole të tilla ka mundësi të merren përsëri me çështjet që janë trajtuar më parë nën titujt pasues në këtë listë:*

1. *kërkesat administrative: A3.2-3*
2. *kostot dhe ndikimi ekonomik: A4.3-5*
3. *efiçenca: A4.9*
4. *praktikueshmëria: A4.11-16*
5. *zbatimi: A4.19-20.*



- E7.1 A parashikojnë rregullimet ligjore se kur draftet e përfunduara të legjislacionit (për shembull, draftet që ka të ngjarë të kenë efekte të rëndësishme sociale ose ekonomike) duhet t'u nënshtrihen verifikimeve të freskëta përpara se të miratohen nga Këshilli i Ministrave dhe të dërgohen në parlament?
- E7.2 A ekzistojnë procedura në fuqi për t'i referuar këto drafte tek organi përkatës që kryen verifikime me qëllim që përfundimet e tyre të merren parasysh nga hartuesi i ligjit kur ai rishikon draftin?

## **F. PUBLIKIMI I LEGJISLACIONIT**

### ***F1. Burimet legjislative***

- F1.1 A ekziston ndonjë gazetë zyrtare (për shembull, gazetë zyrtare/kombëtare) në të cilën botohen tekstet autentike zyrtare të legjislacionit, përfshirë ligjet?
- F1.2 A kërkojnë rregullat që i gjithë legjislacioni, parësor e dytësor, të publikohet në këtë gazetë menjëherë pasi ai është hartuar?
- F1.3 A parashikojnë rregullimet ligjore që i gjithë legjislacioni parësor dhe dytësor duhet të ribotohet në vëllime vjetore?
- F1.4 A është krijuar një regjistër qendror ose një sistem regjistrimi për regjistrimin e të gjithë legjislacionit parësor e dytësor për të mundësuar krijimin dhe mbajtjen e një arkivi të plotë?
- F1.5 Nëse qeveria ka mundësuar krijimin e një baze elektronike të dhënash, ose nëse një gjë e tillë është duke u shqyrtuar të bëhet:
- a) A janë ndërmarrë hapa për të garantuar se ajo e përmban legjislacionin në një formë e cila mund të garantohet nga shteti si autentike, dhe
  - b) A do të lejohen avokatët, gjykatësit, zyrtarët qeveritarë dhe publiku të kenë akses online në të?
- F1.6 A kërkojnë rregullat që të përgatitet dhe të botohet një koleksion i legjislacionit parësor e dytësor (që përmban të gjitha ligjet në fuqi në datën e botimit) në intervale të rregullta?
- F1.7 A ka rregullime ligjore përmes të cilave çdo legjislacion i cili është amenduar themelisht të mund të ribotohet në një formë të konsoliduar e cila është autentike?
- F1.8 A ekziston ndonjë kërkesë për të botuar në intervale të rregullta një indeks zyrtar të përditësuar të legjislacionit në fuqi i cili të tregojë gjithashtu ku, kur dhe si është amenduar legjislacioni i mëparshëm?
- F1.9 A i kërkohet çdo ministrie të ruajë një koleksion të plotë të legjislacionit aktual mbi çështje brenda fushës së kompetencës së saj?
- F1.10 A ka çdo ministri akses në një koleksion të plotë të të gjithë legjislacionit në fuqi? Në veçanti, a kanë të gjithë hartuesit e ligjit akses në të gjithë korpusin legjislativ?
- F1.11 A mbahen koleksionet e plota të legjislacionit aktual në qendra në të cilat kanë akses juristët dhe publiku? A ka fonde të mjaftueshme në dispozicion që të garantojnë se këto koleksione përgjithësisht mirëmbahen?
- F1.12 A munden juristët dhe ndërmarrjet e sektorit privat të sigurojnë me lehtësi një komplet të plotë dhe autentik të legjislacionit në fuqi? A janë të gjenden me lehtësi kopje të instrumenteve individuale në të gjithë vendin dhe me një çmim të cilin publiku mund ta përballojë?

- F1.13 A ka formuar ose ngarkuar qeveria ndonjë organ ose organe me përgjegjësinë të:
- a) rishikojë legjislacionit aktual (për shembull, me synimin e sjelljes së propozimeve për shfuqizimin e atij legjislacioni i cili është i vjetëruar ose nuk është më efektiv), dhe
  - b) përgatisë dhe publikojë në intervale të rregullta koleksione të legjislacionit aktual parësor dhe/ose dytësor në fuqi?

**F2. Botimi i legjislacionit**

- F2.1 A parashikojnë rregullimet ligjore një kalendar kohor për printimin e ligjeve pas miratimit nga qeveria ose iniciimit nga deputetët dhe përpara se të dërgohen në parlament?
- F2.2 A e parashikojnë rregullimet ligjore fazën e procesit hartues në të cilën ligji duhet të botohet, dhe momentin kur ai duhet t'i vihet në dispozicion publikut (për shembull, për blerje) dhe se kujt i duhen dërguar automatikisht kopje *falas*?
- F2.3 A e parashikojnë rregullimet ligjore se me buxhetet e kujt (për shembull, të të gjithë qeverisë, të ministrive të veçanta, të parlamentit) do të përballohen kostot e printimit dhe të botimit të legjislacionit?
- F2.4 A e bëjnë të qartë rregullimet ligjore se kush e ka autoritetin të bëjë ndryshime në tekstin e legjislacionit pasi ai është hartuar, por përpara publikimit përfundimtar të tij dhe në çfarë rrethanash (për shembull, të korrigjojë gabimet e shtypit)?
- F2.5 A e parashikojnë rregullimet ligjore se sa shpejt duhet të publikohet zyrtarisht legjislacioni pasi ai të ketë hyrë në fuqi si edhe rrethanat e veçanta në të cilat ai mund të hyjë në fuqi përpara se të jetë botuar?

## SHTOJCA 1-Fjalor

*Legjislacion amendues:* legjislacion që ndryshon efektin e legjislacionit ekzistues, ose nëpërmjet modifikimit ose shfuqizimit të dispozitave, ose nëpërmjet shtimit ose zëvendësimit të tyre

*Përafrim i ligjit:* procesi i sjelljes së përmbajtjes së legjislacionit ekzistues në harmoni me kërkesat e ligjeve të BE

*Projekt- ligj:* drafti i legjislacionit parësor në atë formë që do të merret në shqyrtim nga parlamenti

*Konsolidim:* procesi i prodhimit të një koleksioni koherent dhe të plotë të legjislacionit, ose të rregullave legjislative për një fushë të caktuar dhe në një format të organizuar

*Vlerësim ex ante:* procesi i vlerësimit cilësor të një tipari të legjislacionit të propozuar përpara se të merret një vendim përfundimtar për ta miratuar atë

*Hartues ligji:* një person (ose një zyrtar qeverie ose një konsulent i kontraktuar) i angazhuar për prodhimin e tekstit të legjislacionit të ri

*Hartimi i ligjit:* procesi i konvertimit të një politike të re në rregulla ligjore në legjislacion, në formën dhe në stilin e përshtatshëm ligjor, para se të ndodhë ligjbërja

*Legjislacion:* ligji i shkruar i bërë nga parlamenti, nga qeveria ose nga organe të tjera të pajisura me kompetenca (zakonisht nga kushtetuta) për të nxjerrë instrumente ligjbërëse

*Legjislacion parësor:* legjislacioni i përgatitur nga parlamenti (për shembull, organi i pajisur me funksionin kryesor të hartimit të ligjit për nevojat e shtetit)

*Kuadër rregullator:* rregullimet ligjore standarde (siç diktohen nga ligji) për përgatitjen e legjislacionit, përfshirë këtu të gjitha kërkesat ligjore për procedurat standarde që duhen ndjekur dhe për formën dhe stilin në të cilin duhet të hartohet legjislacioni

*Rregull:* çdonjëri prej gamës së instrumenteve ligjore që mund të bëhen nga parlamenti, qeveria ose administrata publike për të ndikuar mbi sjelljen (për shembull, instrumentet ligjore, të tilla si legjislacioni parësor e dytësor, dhe instrumentet joligjore si qarkoret, direktivat, udhëzimet ose instruksionet)

*Menaxhim rregullator:* menaxhimi sistematik i proceseve të krijimit, hartimit, dhe bërjes së legjislacionit të ri

*Legjislacion dytësor:* instrumentet normative (për shembull, dekretet, direktivat, rregulloret, rregullat, urdhrat) e përgatitura nga qeveria ose një organ tjetër ekzekutiv i pajisur me kompetencën për të nxjerrë instrumente të tilla për zbatimin e legjislacionit parësor

*Verifikim:* një proces për shqyrtimin e hollësishëm të një propozimi për politika ose të një projekt-ligji me qëllim që të kontrollohet nëse ai i përmbush disa standarde të posaçme ose cilësinë e kërkuar

## SHTOJCA 2- Lista e kontrollit e OECD-së për Vendimmarrjen Rregullatore

Rekomandimi i Këshillit të OECD-së, miratuar në 9 mars 1995

Dhjetë pyetjet në vijim për vendimet rregullatore pasqyrojnë parimet e vendimmarrjes së mirë që janë në përdorim në vendet anëtare të OECD-së për të përmirësuar efektivitetin dhe efikasitetin e rregullimeve qeveritare nëpërmjet përmirësimit të bazës ligjore dhe faktuale për rregulla, sqarimit të alternativave, ofrimit të ndihmës punonjësve për arritjen e vendimeve më të mira, vendosjes së proceseve vendimmarrëse më të rregullta dhe më të parashikueshme, identifikimit të rregulloreve ekzistuese që u ka kaluar koha ose që janë të panevojshme, dhe duke i bërë veprimet e qeverisë më transparente. Por këto duhet të zbatohen në kuadrin e një sistemi më të gjerë menaxhimi rregullator i cili përfshin elemente të tilla si informimi, grumbullimi dhe analiza, proceset konsultative dhe vlerësimet sistematike të rregullimeve ekzistuese.

1. A është përkufizuar siç duhet problemi?

Problemi që kërkon zgjidhje duhet të formulohet në mënyrë të saktë, duke dhënë fakte të qarta për natyrën dhe përmasat e tij dhe duke shpjeguar pse ka lindur ai (duke identifikuar stimujt për organet e prekura).

2. A është i justifikuar veprimi qeveritar?

Ndërhyrja e qeverisë duhet të bazohet në të dhëna të qarta që të justifikojnë veprimin e qeverisë, duke pasur parasysh natyrën e problemit, përfitimet dhe kostot e mundshme të veprimit (bazuar në një vlerësim realist të efektivitetit të qeverisë), dhe mekanizmat alternativë për trajtimin e problemit.

3. A është nxjerrja e rregullimeve ligjore forma më e mirë e veprimit qeveritar?

Ligjbërësit duhet të kryejnë që herët në procesin rregullator një vlerësim të informuar të një numri instrumentesh rregullatore e jorregullatore të politikave, duke mbajtur parasysh çështje të rëndësishme si kostot, përfitimet, efektet e shpërndarjes, dhe kërkesat administrative.

4. A ekziston një bazë ligjore për rregullimet?

Proceset rregullatore duhet të strukturohen në mënyrë të tillë që vendimet rregullatore të respektojnë rigorozisht “shtetin e së drejtës”, pra, që përgjegjësia duhet të jetë e qartë për të garantuar që të gjitha rregullimet janë të autorizuara nga rregullime ligjore të nivelit më të lartë dhe të jenë në përputhje me detyrimet e traktateve, si edhe me parime të rëndësishme ligjore të tilla si siguria, proporcionaliteti dhe kërkesa procedurale të zbatueshme.

5. Cili është niveli (ose nivelet) i përshtatshëm i qeverisë për këtë veprim?

Ligj bërësit duhet të zgjedhin nivelin më të përshtatshëm të qeverisë i cili duhet të vihet në veprim, ose, nëse përfshihen nivele të ndryshme, atëherë duhet të ndërtojnë sisteme efektive të koordinimit midis niveleve të qeverisë.

6. A i justifikojnë kostot përfitimet nga rregullimi i ri?

Ligj bërësit duhet të vlerësojnë kostot dhe përfitimet e përgjithshme të pritshme të çdo propozimi rregullator dhe të alternativave të mundshme, dhe duhet t'i vënë këto vlerësime në dispozicion të vendimmarrësve në format të arritshëm dhe të përdorshëm. Kostot e veprimit qeveritar duhet të justifikohen prej përfitimeve përpara se të ndërmerret veprimi qeveritar.

7. A është transparente shpërndarja e efekteve në shoqëri?

Për shkak se vlerat e shpërndarjes dhe të barazisë preken nga ndërhyrja e qeverisë, ligj bërësit duhet të bëjnë transparente shpërndarjen e kostove dhe të përfitimeve rregullatore midis grupeve shoqërore.

8. A është rregullimi ligjor i qartë, konsistent, i plotë dhe i aksesueshëm për përdoruesit?

Ligjërësit duhet të vlerësojnë nëse rregullat do të kuptohen nga përdoruesit e mundshëm, dhe për këtë qëllim ata duhet të hedhin hapa për të garantuar se teksti dhe struktura e rregullave janë aq të qarta sa është e mundur.

9. A e kanë pasur mundësinë të gjitha palët e interesuara të shprehin pikëpamjet e tyre?

Rregullimet duhet të hartohen në një mënyrë të hapur dhe transparente, me procedura të përshtatshme për të siguruar mendime efektive dhe në kohë nga palët e interesuara të tilla si bizneset dhe sindikatat e prekura, grupet e tjera të interesit ose nivelet e tjera të qeverisë.

10. Si do të arrihet përputhshmëria?

Ligjërësit duhet të vlerësojnë stimujt dhe institucionet përmes së cilave rregullat do të bëhen efektive dhe duhet gjithashtu të hartojnë strategji zbatimi të afta për të reaguar me qëllim që t'i shfrytëzojnë ato sa më mirë.